

VENDIM
Nr.45, datë 21.1.2009

**PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK NË MËNYRË
ELEKTRONIKE**

(Ndryshuar me VKM nr. 216, datë 11.2.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të gjitha procedurat e prokurimit të zhvillohen me mjete elektronike *me përjashtim të procedurave të prokurimit, me objekt “Blerja e energjisë elektrike” dhe “Menaxhimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve, si dhe operimi i tunelit të Thirrës, në autostradën Rrëshen-Kalimash.*

2. Ngarkohet Agjencia e Prokurimit Publik të nxjerrë udhëzimet përkatëse, në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha